

Kërkimi i vendit të mësimit të profesionit- si të bëhët më së miri?

Përcaktimi i profesionit

Nëse shkon të kërkosh një vend për mësimin e profesionit/zejes, duhet që profesioni yt të jetë i përcaktuar. Më fjalë të tjera: ti e di që do të sjellësh aftësitë e tua te nevojshme për profesionin e zgjedhur. Kjo është më rëndësi, dhe të mundëson qëllimisht që të kërkosh në një vend për të cilin je përcaktuar, dhe jo të orientohesh pa planifikuar fare që të hysh, në vendin e parë dhe më të mirin që t'a gjesh.

Mbledhja e adresave

Tani ti mund të sjellësh përvoja, se cilat ndërmarrje në profesionin tënd të dëshiruar ofrojnë një vend të lirë për mësimin e profesionit gjatë verës që vjen. Për këtë ti ke mundësi dhe mjete të ndryshme në dispozitim:

- Në Këshillimorën për Profesione ¹ do të gjesh lista të ndërmarrjeve të cilat kanë mundësi të shkollojnë nxënësit/et në profesionin e dëshiruar.
- Në internet janë të dhëna vendet e lira për mësimin e profesionit.²
- Vende të lira për mësimin e profesionit mund të gjesh në revista falas dhe gazeta ditore si dhe në faqe interneti të ndërmarrjeve të ndryshme.
- Shumë nxënës dhe nxënëse vijnë deri te një vend i lirë për mësimin e profesionit, përmes të njohurve ose të afërmve. Shfrytëzoni lidhjet dhe miqësitë e mundshme.

Kontakto

Tani i ke adresat e përshtatshme. Lajmërohu te ndërmarrjet të cilat faktikisht kanë vende të lira. Shfrytëzo për kontakt të parë telefonin, ose shko vetë atje. Pastaj, në rastin e përshtatshëm pyet se si mund të konkurosh. Mënyrat e paraqitjes ndryshojnë nga ndërmarrja në ndërmarrje. Një ndërmarrje e dëshiron një kërkesë me shkrim, ndërsa një tjetër dëshiron që të njoh drejtpërdrejt. Me rëndësi është që të konkurosh ashtu si ata kërkojnë.

Konkuro

¹ Secili kanton e ka së paku një Këshillimorë për Profesione
Adresat mund të merren në shkollë, në komunën tuaj, apo në internet:
Deutsch: www.adressen.sdbb.ch Français: www.adresses.csfo.ch Italiano: www.indirizzi.csfo.ch

Këshillimorja për Profesione dhe Qendra Informativë për Profesione ÇIP është shpesh e njohur me një emër të veçantë ose me një shkurtesë:
Gjermanisht BIZ, Laufbahnzentrum
Frëngjishtl OP, SOPFA, OFPC, COS, OROSP, CIO, OCOSP
Italisht orientamento, UOSP

² Vende të lira për mësime të profesioneve:
Gjermanisht www.berufsberatung.ch/Lehrstellen
Frëngjishtl www.orientation.ch/apprentissage
Italisht www.orientamento.ch/tirocinio

Një kërkesë me shkrim heret apo vonë kërkohet nga të gjitha ndërmarrjet. Ka rregulla të qarta, se si duhet të duket një dosje e tillë dhe çka përmban ajo. Nëse ke veshtërsi në përgaditjen e dosjes për konkurim, atëherë mund të marrësh ndihmë në shkollë ose në këshillimorën për profesione.

Poashtu në internet mund të gjesh dosje për konkurim.³

E rëndësishme është që dosjën tënde për konkurim para se t'a dërgosh, t'ja tregosh një personi përgjegjës për t'a kontrolluar, sepse ajo duhet të jet e plotë, pa gabime dhe e përshtatshme për profesionin dhe ndërmarrjen.

Ja edhe një këshillë: Mundësisht konkuro në shumë vende njëkohësisht. Kështu do të zmadhosh shanset tua për gjetjen e një vendi për mësimin e profesionit.

Mbaj evidencë

Është e arsyeshme që ta mbash një kontroll mbi të gjitha aktivitetet e konkurimeve të bëra. Më së miri është që për këtë qëllim të bësh një listë, në të cilën do të shënosh së kur ke konkuruar, se a të kanë caktuar ndonjë takim apo deri kur do të informohesh. Kështu ti e din çdo herë se çka është e kryer, prej kujt pret përgjigje dhe kur mund të pyesësh.

Zotëro provimet dhe bisedat

Gjithnjë e më shumë ndërmarrje dhe organizata kërkojnë që të bësh një test të aftësisë. Informohu se si duket ky test në profesionin e dëshiruar dhe çka kërkohet.

Kur të vish deri tek zgjedhja e ngushtë, kryepunëtori/ja do të dëshiroj që të njohë personalisht. Përgatitu me kohë për këtë bisedë prezantuese. Paramendoj pyetjet dhe përgjigjet e mundshme. Nëse je e/i pa sigurt, bisedo me ndokënd. Përshtypja që u mbetet nga kjo bisedë prezantuese, luan një rol shumë më rëndësi. Për këtë paraqitu sa më mirë, tregohu i interesuar dhe i motivuar

Përballo refuzimet

Situata për kërkimin e vendit për mësim të profesionit në shumë profesione, është e vështirë. Për këtë duhet të llogaritësh edhe me refuzime të kërkesave tua. Mos lejo në asnjë mënyrë që të demoralizohesh. Qendro aty dhe përpiku edhe më tutje. Kërko arsyet e refuzimit. Kështu është e mundshme që në të ardhmen të përmirësosh diçka dhe të rrisësh shanset për sukses.

Bëhu fleksibil

Mos këmbëngul vetëm për një profesion. Ndoshta në profesionin e dëshiruar nuk do të gjeshe vend për mësimin e profesionit. Atëherë është më rëndësi që për zgjedhje tjera të jesh i/e hapur.

Nëse përkundër përpjekjeve të mëdha, një kohë të gjatë nuk ke gjetur vend në profesionin e dëshiruar, është e domosdoshme që situatën ta analizosh me kujdes. Kërko mundësitë në ndonjë profesion të përafërt, një vit kalimtar, një praktikë, një vit shkollimi gjuhësor etj. Reago më kohë mblidh informata ose kërko ndihmë të nevojshme. Bisedo gjithsesi me këshilltarin ose këshilltaren dhe planifiko veprimet e

³

Gjermanisht: www.berufsberatung.ch > Direkteinstieg Schüler > Lehrstellensuche > Lehrstellenbewerbung

Frëngjishtl: www.orientation.ch > accès direct > A l'école > Places d'apprentissage > Rechercher une place d'apprentissage

Italisht: www.orientamento.ch > Accesso diretto > Allievi scuola media > Posti di tironico > Ricerca di un posto di tironico

mëtutjeshme. Përfundimi i një shkollimi themelor profesional (ose një shkolle të mesme) të hap rrugë dhe është një shtyllë e rëndesishme për ardhmerinë tënde. Kështu, ti ke mundësi të ndryshme për zhvillimin tënd të mëtutjeshëm.